



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.445/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NPB sh.a me seli ne Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Prishtinë, në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Departamenti i Ekonomik, KPPP.nr.1904/22 te datës 15.01.2024, me datën 04.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinë, në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Departamenti i Ekonomik, KPPP.nr.1904/22 te datës 15.01.2024, Vërtetohet.

**Arsyetim**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Departamenti i Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1904/22 te datës 15.01.2024, e ka aprovuar pjesërisht si te bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës dhe anulohet pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr. 112/22, i lejuar me date 23.02.2022, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, per pjesën detyrimit ne lartësi prej EUR 102,641.23 dhe ne këtë pjese te përmbarimit procedura përfundohet. Kurse ne piken II te dispozitivit ka vendosur qe te refuzohet pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr.112/22, i lejuar me date 23.02.2022, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, per borgjin ne lartësi prej EUR 313,033.00 se bashku me kumatën ligjore ne këtë pjese te borxhit dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe urdhrin përmbarimor te shfuqizoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë, e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 22.02.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me nr.303 te datës 23.12.2020 per shumen e mjeteve ne lartesi 325,558.70 si dhe faturës 318 te datës 24.11.2021 per shumen e mjeteve ne lartesi 90,115.53 euro, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura, t'i paguaj shumën e kredis se kërkuar si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 03.03.2022, ne prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se faturat mbi bazën e se cilave është lejuar urdhri nuk përbëjnë dokument përmbartues ngase nuk janë te pranuar as nga menaxheri i kontratës dhe as nga autoriteti kontraktues, ndërsa ka shtuar se kreditori nuk ka bashkangjitur asnjë fletëporosi e cila do te duhej te ishte bere nga debitorit sipas kontratës, ashtu qe nuk është vërtetuar as kryerja e shërbimeve nga ana e kreditorit. Me tej, ka theksuar se faturat janë dorëzuar ne kopje te pavërtetuara, te njëjtat janë te panëshkruara nga palët, ju mungon afati i pagesës dhe nuk ju dihet burimi. Ne fund, ka shtuar se kontrata mes palëve eshte lidhur për periudhën një vjeçare duke filluar nga data 24.02.2020 e deri me 24.02.2020, ndërsa fatura është lëshuar nga kreditori me date 23.12.2020 mirëpo është protokolluar me date 07.05.2021 dhe ne te njëjtën date është kërkuar edhe pagesa, ndërsa nuk janë ofruar dëshmi se ne cilën periudhe janë kryer punimet. Per keto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta pranoj si te bazuar, ndërsa urdhri përmbartimorë te anulohet.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit, ka paraqitur kreditori me pretendimin qe te refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, pasi qe ka për qellim prolongimin e procedurës. Ne fund, ka theksuar se duke e mirëkuptuar debitorin, i cili me fajin e tij me vones ka inspektuar punët, kreditori ka lëshuar kredit notën nr. 303, te datës 25.01.2022 duke zbritur vlerën monetare te faturës nr. 303, te datës 23.12.2020 nga shuma prej EUR 325,558.70 në EUR 222,917.60, ashtu qe ka propozuar qe urdhri përmbartimor tani te mbetet ne fuqi vetëm për shumen ne vlere prej EUR 222,917.60 sipas faturës 303 dhe shumen prej EUR 90,115.53, sipas faturës 318, apo shumën e përgjithshme prej EUR 313,033.00

Gjykata e shkalles se parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si te bazuar prapësimin e debitorit refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës dhe anulohet pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 112/22, i lejuar me date 23.02.2022, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, për pjesën detyrimit ne lartësi prej EUR 102,641.23 dhe ne këtë pjese te përmbartimit procedura përfundohet. Kurse ne piken II te dispozitivit ka vendosur qe te refuzohet pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr.112/22, i lejuar me date 23.02.2022, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, per borgjin ne lartësi prej EUR 313,033.00 se bashku me kamatën ligjore ne këtë pjese te borxhit dhe shpenzimet e procedurës

përmbardimore. Gjykata arsyeton se fatura mbi te cilën bazohet propozimi për përmbardim i plotëson te gjitha kushtet ligjore konform nenit 29 dhe 37 te LPP. Pra urdhri përmbardimor bazohet ne dokument te besueshëm. Andaj gjykata e shkalles se parë, vlerëson se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore te parapara me nenin 71 te LPP, andaj konform nenit 71 dhe 73 te LPP ka vendos si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Dhoma e Shkalles e Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbarduesit privat, me të cilin është caktuar përmbardimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbardimi është lejuar në bazë të Faturës, e po ashtu kreditori ka lëshuar kredit notën nr. 303, te datës 25.01.2022 duke zbritur vlerën monetare te faturës nr. 303, te datës 23.12.2020 nga shuma prej EUR 325,558.70 në EUR 222,917.60, ashtu qe ka propozuar qe urdhri përmbardimor tani te mbetet ne fuqi vetëm për shumen ne vlere prej EUR 222,917.60 sipas faturës 303 dhe shumen prej EUR 90,115.53, sipas faturës 318, apo shumën e përgjithshme prej EUR 313,033.00, në mbështetje të nenit 29 par.3 i LPP i cili thotë, se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, kjo faturë ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe e njëjta si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbardimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbardim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë ne pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbardim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimi ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te

gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë, i vlerësoj edhe pretendimet ankimore, mirëpo nga shkresat e lendes konstatoj se propozimi për përmbarrim është hartuar në mënyrë të rregullt, e po ashtu debitori e ka pranuar faturën në mënyrë të rregullt.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm, të cilën kreditori ia ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarrim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarrimit dhe se kjo faturë ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarrimit.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat e paraqitura nga ana e të paditurës, ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e njëkohësisht ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, por vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë, sepse debitori nuk i ka argumentuar me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, dhe se të tilla nuk ndikojnë në një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.445/24 me datë 04.06.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**